



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 10-111-01-32868-24

Nr. i Titullit / No. ng.

Data / Datum / Date

22.10.2024

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



**Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opština Obilic/Municipality of Obiliq**

Bazuar në nenet 6,8,9,10,11,12,13,14 dhe 15 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave Dhe Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit dhe Aktivitetet Jashtëshkollore me Nr. -I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me nr.10-104-02-31181/2024 të datës 03.10.2024, Drejtoria e Arsimit më 22.10.2024 shpall:

KONKURS

(për ndarjen e bursave të studentëve në universitetet publike për nivelet e studimeve themelore-bachelor, master dhe doktoraturës për vitin akademik 2024-2025)

Kushtet dhe kriteret:

1. Të drejtë për bursë komunale kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë banorë të Komunës së Obiliqit.
- Të jenë të regjistruar studentë të rregullt në vitin akademik, për të cilin ndahet bursa

1.1. Niveli i studimeve themelore (bachelor):

1.1.1 Të jenë studentë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve, përjashtim bëjnë, studentët me aftësi të kufizuara, studentët fëmijë të dëshmorëve, studentët jetimë (me një prind ose pa asnjërin prind) dhe studentët familjet e të cilëve janë raste sociale, të cilët përfitojnë bursë edhe për vitin e parë të studimeve, si studentë të rregullt.

1.1.2. Të kenë të regjistruar për herë të parë vitin (gjegjësisht semestrin e vitit) për të cilin ndahet bursa.

1.2. Niveli i studimeve master për drejtimet:

1.2.1 Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Kimisë dhe Departamenti i Biologjisë përkatësisht drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje të Mjedisit;

1.2.2 Fakulteti i Edukimit;

1.2.3 Fakulteti Teknik;

1.2.4 Specializimet në lëmin e mjekësisë;

1.2.5 Arkitekturë dhe Ndërtimtari;

1.2.6 Studentë të të gjitha drejtimeve të studimeve, për të cilët në bazë të mundësive buxhetore në pajtim me nenin 8 vendos komisioni për ndarjen e bursës,

1.2.7 Drejtimet nga pika 1 deri në pikën 5 të nenit 9 do të kenë prioritet në ndarjen e bursave.

1.3 . Niveli i doktoratës:

1.3.1 Nga të gjitha lëmit e studimeve me kusht që të ketë punime shkencore të publikuara në ndonjë revistë shkencore, (përjashtim bëhet për studentët ,të cilët janë në vitin e parë, duhet të dëshmojnë pagesën e semestrit të parë).

Dokumentet e obliguara janë:

- Fletëkërkesa
- Vërtetimi i regjistrimit të vitit akademik,semestrit
- Ekstraktin e lindjes
- Kartela (ID) e studentit
- Vërtetimi i notave dhe nota mesatare nga fakulteti
- Kopja e letërnjoftimit
- Konfirmimi bankar

Dokumentet plotësuese për bonuset sipas kategorive , neni 11 i kësaj rregulloreje

- Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale në Obiliq (vetëm për familjet që marrin asistencë sociale)
- Vërtetimi për prindërin se është dëshmor i UÇK-së
- Vërtetimi për prindërin se është veteran i UÇK-së
- Vërtetimi për prindërin se është invalid i UÇK-së
- Vërtetimin për prindërin se ka qenë i burgosur politik
- Dëshmi se studenti apo studentja është me nevoja të veçanta
- Dëshmi se studenti apo studentja është nga komunitetet pakicë
- Dëshmi se studenti apo studentja nuk ka prindër
- Dëshmi se studenti apo studentja nuk jeton me prindër
- Dëshmi se në familje kanë më shumë se dy studentë
- Certifikata që studenti, studentja është banor i komunës së Obiliqit

Sqarim :Studentët kanë të drejtë përfitimi vetëm në një kategori.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimit të KK-së ,ose në faqe zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurrimit është 15 ditë pune.

Drejtoreshë në DA :Fitore Hashani

